



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr.287, datë 29.05.2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT, PËR POZICIONIN E LIRË, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 290, DATË 06.07.2021, PËR KANDIDATIN Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.05.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e z. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi,

**VËREN**

**I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET**

1. Me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

*“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.*

...

2. Në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, afati i kandidimit është përcaktuar “*deri më datë 21.07.2021*”. Vendimi si më lart, krahas edhe një njoftimi për hapjen e kësaj procedure ngritjeje në detyrë, janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Këshillit më datë 06.07.2021, duke filluar të ecë afati i kandidimit nga dita e nesërme.

3. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, aktualisht gjyqtar i skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

## II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Me Vendimin nr. 334, datë 28.07.2021, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin sipas pikës 1, të këtij vendimi, Këshilli ka vendosur:

*“1 Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*5. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedura e verifikimit të kriterëve të kandidimit që ka përfunduar për këtë kandidim, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

*...”.*

5. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale si dhe kriteret e pasurisë dhe atë të figurës të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të përmendur më lart, Këshilli me Vendimin nr.356, datë 09.09.2021, ka vendosur:

*1.Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

6. Ndërkohë, me Vendim nr. 393, datë 22.09.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” Këshilli vendosi filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Ilir Toska.

6.1 Referuar sa me lartë si dhe bazuar Vendimit nr. 582, datë 13.12.2021 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Toska”, Këshilli, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr. 70, datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” vendimin nr. 393, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” me Vendimin nr.25 datë 17.01.2022 vendosi " Ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 393, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në

Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë: Caktimin e z. Alban Toro, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit."

7. Më datë 18.01.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 393, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor në përfundim të përmbylljes së vlerësimeve etikë profesionale të kandidateve konkurrent për pozicionin e lirë të shpallur me nr. 209 datë 06.07.2021 vijoi me procedurën e renditjes për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, ku me vendimin nr.231 datë 11.05.2023 vendosi :

1. *Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:*
  - 1) *Znj. Enerjeta Shehaj*
  - 2) *Z. {...}*
2. *Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. Enerjeta Shehaj dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.*
3. *Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.*

### **III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI**

9. Në vijim të procedurës së renditjes dhe në pritje të afateve të ankimit sipas pikës 3 të vendimit të renditjes nr.231 datë 11.05.2023, kandidati z. {...}, me shkresën e datës 18.05.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr. 2930 prot., ka parashtruar se **tërhiqej nga kandidimi për pozicionin** e lirë, i shpallur me vendimin nr. 290 datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për arsye se do të kandidonte në pozicionet e tjera të cilat priten të shpallen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

10. Në rrethanat sa sipër, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare”.

11. Në Mbledhjen e datës 24.05.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290 datë 06.07.2021, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit 70/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

#### **IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT**

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të gjitha niveleve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

13. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t'u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *"Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka".* Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *"Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë".*

14. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 70/2020. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 36, të tij, përcaktohet se: *"Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare".*

15. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290 datë 06.07.2021. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, duke parashtruar

rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i tij për t'u tërhequr nga kandidimi.

## **V. KONKLUSIONE**

16. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290 datë 06.07.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...} , për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**